



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0082670-1/23 dt. 22.11.2023

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 24

Koha: 22.11.2023 ora 10:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shosholli Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyjeta Imeri
Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza
Drejtorët e Drejtorive

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; neni 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e njëzetekatër të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim-Rregullore Nr. ___/2023 Për ndarjen e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë
3. Propozim-vendim për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024
4. Propozim-vendim për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera
5. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit “Lah Nimani”

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Propozim-Rregulloren Nr. ___/2023 Për ndarjen e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë.

Vesel Neziri: Ju përgëzoj për këtë propozim-rregullore, kam vetëm një plotësim të neni 4, propozoj të riformulohet: Të drejtë aplikimi për bursë komunale kanë të gjithë nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë. Sepse në mënyrën qysh shkruan në propozim-rregullore të drejtë aplikimi kanë vetëm nxënësit që aplikojnë në afatin e parë.

Kryetari Bedri Hamza: Pajtohem me propozimin e z. Neziri, nuk duam që Rregullorja të jetë diskriminuese, prandaj të riformulohet neni 4.

Hysen Muzliukaj: Për shkak të kriterëve diskriminuese këtë propozim-rregullore ne e kemi tërheqë nga rendi i ditës në një prej mbledhjeve të kaluara të KPF-së, nuk duhet të kemi rregullore diskriminuese, të drejtë aplikimi duhet të kenë të gjithë nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani”, ndërsa me konkurs mund të specifikohen kriteret.

Fadil Veseli: Të drejtë aplikimi a duhet të kenë vetëm nxënësit banorë të Mitrovicës apo të gjithë nxënësit e kësaj shkolle, kjo është mirë të qartësohet për mbledhjen e Kuvendit.

Shkurta Shosholli Musa: Është kënaqësi e madhe që po e ndajmë këtë eksperiencë, për shkak të politikave të këqija gjendja në këtë shkollë viteve të fundit është rënduar së tepërmi, e ne e dimë të gjithë kur kjo shkollë ka qenë në kulminacionin e saj. Jam shumë e lumtur që kanë filluar politikat ose mekanizmat për ngritjen e kësaj shkolle, kjo rregullore është njëra prej saj, edhe njëherë po e them që më vjen shumë mirë që po punohet në drejtim të ngritjes së kësaj shkolle.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim-Rregulloren Nr. ___/2023 Për ndarjen e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, me propozimin që neni 4 të riformulohet si në vijim: *Të drejtë aplikimi për bursë komunale kanë të gjithë nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë.*

Propozim-Rregullorja Nr. ___/2023 Për ndarjen e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, me propozimin që neni 4 të riformulohet si në vijim: Të drejtë aplikimi për bursë komunale kanë të gjithë nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë; u miratua unanimisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja znj. Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.

Fadil Veseli: Propozoj që të formohet një Komision për ndërrimin e emrave të këtyre pronave, që sa vite pas luftës e këto prona ende i kanë emrat në gjuhën serbe.

Hysen Muzliukaj: Të gjitha pronat e planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024, sipas listës që është propozuar parashihet të ipen në shfrytëzim afatgjatë, a ka ndonjë pronë që propozohet të ipet në shfrytëzim afatshkurtër.

Artan Berisha: Sa i përket çështjes që e ngriti z. Veseli, kemi biseduar me Agjencinë Kadastrale të Kosovës për ndërrimin e emrave të këtyre pronave dhe ky proces pritet të fillojë shpejtë, ndërsa sa i përket çështjes që e ngriti z. Muzliukaj, lista në bazë të ligjit të ri çdo 6 muaj do të rifreskohet, lista që është propozuar është për 6 mujorin e parë dhe është krejt afatgjatë, ndërsa në 6 mujorin e dytë varet edhe prej kërkesave që do të bëhen.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.

Propozim-vendimi për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024 u miratua unanimitisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Pika 4

Kryesuesja znj. Vesa Broja hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera.

Fadil Veseli: Më intereson të di a janë kryer të gjitha procedurat, pra a janë shpërndarë. Sa i përket subvencionimit me koshere për bletë, në bazë të përvojës që kam po u jap një këshillë sepse kur po bëhet shpërndarja e bletëve 90% po dështojnë, prandaj duhet të kihen parasysh dy faktorë: e para nëse shpërndarja bëhet pas muajit gusht dështimi është i garantuar, si dhe nëse kosherja ka më pak se 5 korniza me miza, nuk mbijetojnë.

Vesel Neziri: E falënderoj Drejtorin e DBZHR-së z. Ferdi Kadriun për punën e mirë dhe të përgjegjshme që po e bën.

Hysen Muzliukaj: Kam një propozim, të formohet lista e zezë me emrat e fermerëve që abuzojnë me subvencionet, për 2-3 vite mos të mund të aplikojnë për asnjë subvencion, sepse të njëjtit po e rrisin konkurrencën dhe po e prishin tregun.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera.

Propozim-vendimi për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera u miratua unanimitisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani", propozoi që pjesë e Komisionit të jenë edhe katër anëtarë nga radhët e Kuvendit, pra Komisioni t'i ketë 9 anëtarë.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) miratoi Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit “Lah Nimani”, me propozimin që pjesë e Komisionit të jenë edhe katër anëtarë nga radhët e Kuvendit, pra Komisioni t’i ketë 9 anëtarë, propozim-vendimi i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:50 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

